



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1209/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Alban Krasniqi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-së në Obiliq, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Alban Krasniqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Obiliq, nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:19 nga Alban Krasniqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Obiliq, pretendon se ka 188 vota ,thuhet në ankesë. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit Alban Krasniqi për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi qe ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 1209/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.